



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË  
GJIP "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISTINA  
MPE "BUS STATION" J.S. PRISTINA

# NPL "Stacioni i Autobusëve" SH. A. Prishtinë Raporti Vjetor 2019



Prishtinë, Mars 2020

## **Përmbajtja**

1. Informata te përgjithshme .....	3
2. Përmbledhje ekzekutive.....	4
3. Sfondi .....	6
4. Prezantimi .....	7
5. Çështjet juridike .....	7
5. Financat .....	10
6. Operativa .....	13
7. Prokurimi.....	16
8. Marrëdhëniet me publikun.....	16
9. Burimet Njerëzore .....	17
10. Digjitalizimi.....	19
11. Auditimi i jashtëm .....	21
Shtojca 1: Rastet Gjyqësore.....	22
Shtojca 2: Pasqyrat financiare (shpenzimet dhe te hyrat).....	23
Shtojca 3: Rekomandimet e auditorit te jashtëm .....	28

## 1. Informata te përgjithshme

Emri i ndërmarrjes:	NPL "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Prishtinë	
Shkurtesa:	SAP	
Pronar:	Kuvendi Komunal i Prishtinës	
Komisioni i aksionarëve:	1. Muhedin Nushi 2. Rifat Deri 3. Mirsad Vitia	
Bordi i drejtoreshë:	1. Faton Raci – Kryesues 2. Anita Morina Saraci – Anëtarë 3. Aferdita Sylja Ismajli – Anëtarë 4. Fatmir Miftari – Anëtarë 5. Luan Hoti – Kryeshef Ekzekutiv	
Kapitali i ndërmarrjes:		11,271,735.84 €
Hapësira/ha:		8.24 ha
Numri i peronave:		24
Numri i hapësirave afariste:		24
Te hyrat per vitin 2019:		1,015,464.93€
Shpenzimet për vitin 2019:		1,001,528.35€
Racio e shpenzimeve:	Paga: 83% Shpenzimet operative dhe administrative: 17%	
Numri i punëtoreshë:		94
Mosha mesatare:		46.52
Balanci gjinor:		66 meshkuj / 28 femra.
Ueb & domain		<a href="http://www.sap-rks.com">www.sap-rks.com</a>

## 2. Përmbledhje ekzekutive

Ndryshimet e bëra në menaxhmentin e në NPL Stacioni i Autobusëve SH. A. Prishtinë, në fund të vitit 2018 dhe në fillim të vitit 2019, gjegjësisht ndërrimi i Bordit të Drejtorëve dhe përzgjedhja e Kryeshefit Ekzekutiv, rezultuan me krijimin e një ambienti shumë më të mirë të të bërit biznes, me kushte shumë më të favorshme pune për të gjithë klientët që marrin shërbime nga Ndërmarrja, si dhe me kushte më të mira të punës edhe për vetë punonjësit e Ndërmarrjes.

Deri në ardhjen e menaxhmentit të ri të gjitha postet më të larta në Ndërmarrje mbuloheshin nga ushtrues detyrash - që nga Kryeshefi Ekzekutiv, Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit (ZKFTH) e deri te Sekretari i Përgjithshëm. I vetmi post i lartë i plotësuar ishte ai i Auditorit të Brendshëm. Përveç menaxhimit skajshmërisht të dobët, ishin edhe këto mangësi ato e vështirësonin edhe më tepër funksionimin dhe funksionalizimin e duhur të Ndërmarrjes. Menaxhmenti i ri arriti që përzgjedhjen e kandidatëve të duhur për këto poste ta përmbyllë deri në tremujorin e katërt të vitit 2019, nëpërmjet konkurseve të hapura publike dhe procedurave të drejta e transparente.

Duke marrë parasysh se ndërmarrjes i mungonin shumë rregulla dhe rregullore të brendshme, dhe se ato ekzistueset (mbase qëllimisht) shpesh ishin të paqarta ose të dy-tre fishuara pa nevojë, me qëllim që të shmanget boshllëku dhe situatat ligjërisht të paqarta, menaxhmenti u detyrua që në fazën e parë të operimit të angazhonte ekspertë të jashtëm me kontrata për punë të veçanta, në mënyrë që të përmbusheshin si duhet detyrimet e Sekretarit dhe ZKFTH-së. Menjëherë pas kësaj, Bordi i Drejtorëve dhe Kryeshefi filluan me përpilimin dhe ndryshimin e rregulloreve të brendshme, me qëllim të funksionimit sa më të mirë të Ndërmarrjes. Si rrjedhojë, u hartuan dhe u miratuan shtatë (7) rregullore të reja, ndërsa një tjetër u ri fuqizua. Veç kësaj, nga ana e kompanive të specializuara u bë matja e saktë e sipërfaqeve dhe vlerësimi i vlerës së qirave të lokaleve afariste, kështu që të gjitha lokalet afariste tani kanë sipërfaqe të saktë dhe qira reale sipas çmimit të tregut.

Në ndërkohë, Auditorit të Brendshëm të ndërmarrjes i skadoi kontrata, e cila nuk iu vazhdua më, për shkak të performancës pothuajse jo ekzistuese gjatë mandatit të deriatëhershëm ligjor.

Paralelisht, gjatë vitit 2019 Ndërmarrja zhvilloi 23 konteste gjyqësore të trashëguara nga menaxhmenti i kaluar, në të cilat ajo përfaqësoi dhe mbrojti me sukses interesat e veta.

Sa i përket anës financiare, me sugjerim të aksionarëve të saj vitin 2019 menaxhmenti i ri e filloi pa shërbimin e Tripodit - një shërbim ky kontrovers dhe i kontestuar nga auto transportuesit dhe udhëtarët, i cili, në bazë të dokumentacionit që ka hasur Bordi dhe Kryeshefi, as nuk e arsyetoi investimin në të nga ish-drejtuësit e Ndërmarrjes. Për më tepër, ky investim tashmë është duke u hetuar nga organet përgjegjëse.

Po ashtu, pas kërkesës së transportuesve, dhe me pëlqimin e aksionarëve të ndërmarrjes, në pjesën e parë të vitit 2019, me Shoqatën e transportuesve rrugorë u arrit një Memorandum i përkohshëm bashkëpunimi (për një periudhë gjashtëmujore), synim i të cilit ishte futja dhe nisja e të gjitha linjave të operatoreve brenda Stacionit të Autobusëve. Me këtë synim edhe u ulë çmimi i të gjitha peronizimeve për mesatarisht 15-30%. Por, përkundër faktit se numri i nisjeve vjetore nga Stacioni u rritë ndjeshëm, meqë nuk u arrit edhe efekti i plotë Memorandumi u shkëput menjëherë pas skadimit të vlefshmërisë së tij. Në ndërkohë,

në marrëveshje me Shoqatën e Transportuesve Rrugorë dhe me Ministrinë e Infrastrukturës, Bordi dhe Kryeshefi i ndërmarrjes i miratuan çmimet e reja të peronizimit, pa zbritje.

Përndryshe, Ndërmarrja gjatë vitit 2019 ka regjistruar gjithsejtë 1,015,464.93 Euro të hyra të realizuara nga shërbimet e saj. Pjesa më e madhe e të hyrave, respektivisht 51.92%, janë realizuar nga shërbimi i peronizimit, përderisa të hyrat nga qiratë e lokaleve afariste përbëjnë 22% të të hyrave gjithmbarshme.

Në krahasim me vitin paraprak (2018), vërehet një rritje e të hyrave pothuajse në të gjitha shërbimet e ofruara nga NPL Stacioni Autobusëve sh.a. Prishtinë.

Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e shpenzimeve në vitin 2019 ka të bëjë me pagat e punonjësve të ndërmarrjes, që përbëjnë 83.82% të shpenzimeve të gjithmbarshme për vitin 2019. Për ndryshe, kjo vlerë aq sa lidhet me pagat e punonjësve poaq ka të bëjë me numrin tejet të madh të tyre, të punësuar nga menaxhmentet e kaluara të ndërmarrjes. Menaxhmenti aktual, në pajtim me aksionarët nuk ka dashur të ulë numrin e punonjësve, duke marrë parasysh gjendjen ekonomike në të cilën ndodhet vendi.

Nga ana tjetër, Bordi dhe Kryeshefi i ndërmarrjes kanë arritur që gjatë vitit 2019 t'i ulin dukshëm të gjitha shpenzimet operative dhe administrative, në ndërkohë që kanë rritur investimet që ndërlidhen me funksionalizimin dhe rregullimin e hapësirave të ndërmarrjes, blerjen e pajisjeve të teknologjisë informative, gardërobës për punonjëse, kontroll sistematik shëndetësor të punonjësve, dezinfektimin, deratizimin, si dhe me investime tjera që kthehen shpejtë (sikurse që është psh investimi në ndarjen e orëve të rrymës për qiramarrës).

Gjatë vitit 2019 janë regjistruar 142,108 linja/nisje gjithsejtë. Që i bije se, krahasuar me vitin paraprak (2018), ka pasur një rritje prej 9%, gjegjësisht 12,735 linja/nisje më tepër. Kjo rritje vjen si rezultat i marrëveshjes me Shoqatën e Transportuesve Rrugor, i përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve në Stacion, i bashkëpunimit ndërmjet stafit të Stacionit me klientët, por edhe me Inspektoratin e Komunikacionit.



Në këtë kontekst, vlen të përmendet se gjatë vitit 2019 një vëmendje e veçantë i është kushtuar përmirësimit të komunikimit të Ndërmarrjes me klientët e saj. Rritja e transparencës ka qenë një prej qëllimeve kryesore, dhe ajo ka arritur nivelin më të lartë ndonjëherë. Ky nivel i transparencës është arritur përmes informimit të rregullt të punonjësve, klientëve dhe të gjithë bashkepunonjësve e partnerëve të Ndërmarrjes për punën dhe aktivitetet e saj.

Një qasje e tillë është mundësuar edhe falë modernizimit, përmirësimit dhe funksionalizimit të Ueb-faqes zyrtare, brenda së cilës mund të lexohen pandërprerë informacione të plota e të përditësuara për Ndërmarrjen në tri gjuhët zyrtare (shqip, serbisht, anglisht), por edhe të bëhet informimi i vazhdueshëm i qytetarëve dhe bashkëpunëtorëve për konkurset dhe dokumentet e ndryshme zyrtare. Ky lloj i komunikimit është fuqizuar edhe në rrjetet sociale (Facebook, Instagram), e cila gjë nuk është praktikuar fare nga menaxhmentet e mëhershme të ndërmarrjes.

Vlen të përmendet se krijimi i domenit të Ndërmarrjes: **sap-rks.com**, por edhe pajisja me server qendror të Ndërmarrjes ka mundësuar lehtësimin e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm.

Gjatë vitit të kaluar janë bërë përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e monitorimit të performacës dhe të respektimit të orarit nga ana e punonjëseve, prandaj edhe është implementuar sistemi i ri i monitorimit dhe i kontrollimit të hyrje–daljeve dhe pushimeve, i cili monitorohet nga Zyra e Burimeve Njerëzore. Ky sistem kryen edhe shumë funksione tjera, duke kontribuar kështu në vlerësimet që bëhen nga Zyra e Burimeve Njerëzore, përfshirë këtu edhe kalkulimin e rrogave të punonjëseve - një funksion ky që më parë nuk ka qenë pjesë e Burimeve Njerëzore.

Gjatë vitit 2019, janë bërë ndryshime të shumta në aspektin e aplikimit praktik të teknologjisë informative në ndërmarrje. Këto ndryshime kanë bërë që Ndërmarrja të kapë hapin për sa i përket aplikimit të teknologjisë informative në proceset e punës, si: në menaxhimin dhe ruajtjen e të dhënave, funksionimin e sistemit të digjitalizimit si pjesë përbërëse të menaxhimit të proceseve të punës, etj.

Në këtë kontekst, vlen të përmendet se gjatë vitit 2019 menaxhmenti është përkujdesur që të gjithë punonjëset e ndërmarrjes të jenë të pajisur me kompjuterë. Natyrisht, për shkak të kapaciteteve financiare të kufizuara të ndërmarrjes, pjesa me e madhe e këtyre pajisjeve të TI-së (kompjuterë, serverë, monitorë) janë blerë të përdorura.

Për të gjitha këto që u thanë më lartë do të elaboratet më detajisht në vazhdim.

### 3. Sfondi

Viti 2019 ishte një vit i ndryshimeve të mëdha në NPL Stacioni i Autobusëve SH. A. Prishtinë.

Me emërimin e Bordit të Drejtorëve, në fund të vitit 2018, dhe përzgjedhjen e Kryeshefit Ekzekutiv, në shkurt të vitit 2019, filloi një etapë e re e zhvillimit të kësaj Ndërmarrjeje Publike Lokale, e cila ishte e keq menaxhuar për një kohë të gjatë, gjë që mund të argumentohet qartë edhe nga raportet e Auditorit të jashtëm për vitet 2017 dhe 2018.

Intervenimet kryesore të Menaxhmentit të ri gjatë vitit 2019 ishin të fokusuara në krijimin e ndryshimeve të qëndrueshme, të cilat rezultuan me krijimin e një ambienti më të mirë të të bërit biznes, nga njëra anë, dhe ndikuan në rritjen e të hyrave nga shërbimet, si burim kryesor i financave të Ndërmarrjes, nga ana tjetër.



Këto ndryshime të arritura në Ndërmarrje janë mirëpritur nga shumica e punonjësve të Ndërmarrjes, megjithëse nuk u pritën aq mirë nga ana e një grupi të vogël, të cilët ishin padrejtësisht të privilegjuar në kohën e menaxhmenteve të kaluara. Këta të fundit, nga frika e ndryshimeve dhe duke shpresuar se procesi i menaxhimit mund të rikthehej në gjendjen e mëparshme, ushtronin një lloj presioni në menaxhmentin e ri dhe tek organet e

ndryshme të ndjekjes përmes dërgimit të letrave dhe kallëzimeve false anonime. Ky lloj i aktiviteteve negative vazhdoi pothuajse gjatë gjithë vitit, megjithëse u menaxhua shumë mirë nga menaxhmenti i Ndërmarrjes.

Përkundër gjithë kësaj, situata e gjithmbarshme në Ndërmarrje ka hapësirë për përmirësim të mëtutjeshëm, ngase një pjesë e borxheve të akumuluarra ndër vite ende mbesin të pa inkasuara, dhe menaxhmenti aktual ende s'po mund të kuptojë arsyen e vërtetë për mosveprim me kohë në këtë drejtim. Në këtë kontekst, janë hasur edhe një numër kontratash që mund të cilësohen si të dëmshme për Ndërmarrjen, e të cilat janë përmbyllur nga menaxhmentet e kaluara. Për më tepër, deri në ardhjen e Bordit dhe Kryeshefit të ri mund të thuhet se nuk është ditur as numri i saktë i punonjëseve, sepse një pjesë e tyre kanë qenë të punësuar apo liruar në mënyrë të parregullt. Shumë punonjës kanë qenë të sistemuar në mënyrë të parregullt, ngase departamentet/sectorët e ndërmarrjes kanë qenë pothuajse jofunksional. Veç kësaj, dyshohet se edhe sistemimi i disa punonjësve është bërë pa meritë, gjegjësisht në bazë të lidhjeve dhe interesave personale që mbretëronin në Ndërmarrje, duke përfshirë këtu edhe ish-Bordin e Drejtorëve.

Si pasojë e gjithë kësaj, Ndërmarrja ka afaruar negativisht për vite të tëra. Por ajo që është edhe më e çuditshme është se edhe planifikimet ishin bërë me humbje, sikurse në rastin e "Planit të Biznesit 2018-2020," gjë që është jashtë çdo logjike ekonomike. Si rrjedhojë e këtij afarizmi negativ ndër vite çështja e Ndërmarrjes ishte diskutuar edhe në Komisionin Parlamentar për Mbikëqyrje të Financave Publike.

Deri në vitin 2019, marrëdhëniet me partnerët kryesorë afaristë - pra me auto transportuesit, kurrë nuk kanë qenë në nivelin e dëshiruar, andaj edhe ka pasur indikacione se shkak i pakënaqësive të tyre, ata mund të organizonin protesta. Po ashtu, një numër i madh i udhëtarëve kanë shmangur nisjet e tyre nga Stacioni i Autobusëve, sepse nuk kanë dashur ta paguanin Tripodin për dalje në peron. Në Ndërmarrje nuk ka ekzistuar as një komunikim i mirëfilltë zyrtar, por i gjithë komunikimi është bërë në mënyrë joformale, ose nëpërmjet e-maileve private. Shumica e punonjëseve nuk kanë pasur fare kompjuterë për t'i kryer punët e tyre ditore, andaj një pjesë bukur e madhe e tyre akoma kanë vështirësi në përdorimin e tij.

Thënë shkurt, para vitit 2019 në Ndërmarrje mbretëronte një gjende kaotike, e cila kishte nevojë për intervenime të shpejta dhe në shumë drejtime.

Siç do të njiheni në vazhdim, të gjitha problemet që u përmendën më sipër, sot pothuajse nuk ekzistojnë më, ngase aktivitetet e ndërmarrja gjatë vitit 2019 nga Bordi i Drejtorëve dhe nga Kryeshefi ndikuan në rikthimin e vullnetit dhe përgjegjësisë, kulturës së punës dhe disiplinës në ndërmarrje.

## 4. Prezantimi

Pjesa në vijim shpjegon të gjitha punët e bëra nga çdo Departament i Ndërmarrjes. Është bërë një punë e madhe duke pasur kapacitete buxhetore të kufizuara por edhe kapacitete njerëzore në Ndërmarrje, që nuk kanë qenë të gatshëm për ndryshim. Pa marrë parasysh, kapacitetet e përmendura, ka qenë një energji pozitive tek punëtorët, sepse pjesa e madhe e punëve është bërë nga punëtorët e Ndërmarrjes, duke kursyer në maksimum buxhetin e saj.

## 5. Çështjet juridike

### Të arriturat

Me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të mirë të punës janë hartuar dhe miratuar rregullore të reja, të cilat i precizojnë qartë çështjet që për synim kanë krijimin e kushteve sa më të mira të punës për punonjës dhe klientë, por edhe për përdoruesit e shërbimeve të ndryshme të Ndërmarrjes.

Gjithsejthe nga Bordi i Drejtorëve janë hartuar dhe miratuar 8 rregullore, 7 prej të cilave janë rregullore të reja, ndërkohë që njëra është rregullore e rikthyer në fuqi, ngase për shkaqe të panjohura ishte shfuqizuar nga ish-Bordi i Drejtorëve.

Rregulloret e miratuara gjatë vitit 2019 janë:

- Rregullorja për organizimin e brendshëm, sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës - maj 2019;
- Rregullorja për marrëdhënie të punës (e ri fuqizuar);
- Rregullorja për përgjegjësitë disiplinore dhe materiale;
- Rregullorja për ndryshim-plotësimin e rregullores për përcaktimin e kritereve të pagës;
- Rregullorja për dhënien e hapësirave afariste me qira, si dhe tokës, sipërfaqeve për vendosjen e objekteve dhe hapësirave reklamuese;
- Rregullorja për menaxhimin e pasurisë jo-financiare, mjeteve themelore dhe aseteve të ndërmarrjes.
- Rregullorja kundër pirjes së duhanit në ambientet e NPL Stacioni i Autobusëve SH. A. Prishtinë;
- Rregullorja për paranë e gatshme.

Me qëllim të përcaktimit të hapësirës së saktë që shfrytëzohet për qiradhënie për biznese dhe vlerësimit të mirëfilltë të qirave për gjitha hapësirat afariste, nga dy kompani të specializuara është bërë matja e këtyre hapësirave të Ndërmarrjes dhe vlerësimi i qirave bazuar në çmimet e tregut. Pas kësaj, në bazë të rregullores së re të miratuar nga Bordi i Drejtorëve, janë ripërtërirë kontratat me 20 biznese ekzistuese.

Veç kësaj, nga menaxhmenti janë miratuar dhe kanë hyrë në fuqi çmimet e reja për shërbimet e parkingut. Çmimet reja janë rritur lehtë, dhe ka filluar një kontroll shumë më rigoroz i hyrje-daljeve në dhe nga hapësirat e parapara për parking.



Me qëllim që të kemi një bashkëpunim sa më të mirë me auto transportuesit, si partnerë kryesorë biznesorë të Ndërmarrjes, me Shoqatën e Auto Transportuesve Rrugorë është nënshkruar marrëveshja e re e peronizimit.

Gjatë vitit kemi pasur 23 lëndë, përfaqësime ose shkresa të ndryshme gjyqësore. Bazuar në aktgjykime e gjykatave, Zyra ligjore e ndërmarrjes ka ndërmarrë hapat e duhur procedural për t'iu përgjigjur padive, përfshirë këtu ushtrimin të ankesave. Pas shterjes së të gjitha

mundësive ligjore mbi të drejtën e ankesës, gjatë gjithë vitit 2019 kemi pasur vetëm një rast me formë përfundimtare të aktgjykimit. Sipas këtij aktgjykimi të Gjykatës së Apelit, detyrimi i Ndërmarrjes ishte që një punonjëseje tashmë të pensionuar t'i paguheshin tri paga, në emër të shpërblimit jubilar. Ndërmarrja në këtë rast veproi sipas Aktgjykimit dhe përmbushi detyrimin e saj ligjor.

Në këtë kontest, edhe disa ish-punonjëseve të tjerë të Ndërmarrjes Gjykata Themelore ua ka aprovuar kërkesat për realizimin e tri pagave në emër të shpërblimit jubilar. Në harmoni me rregullat e procedurës civile, Zyra Ligjore ka ushtruar të drejtën e ankesës dhe aktgjykimet i kemi kundërshtuar në Gjykatën e Apelit. Deri më tani nuk është pranuar përgjigje nga Gjykata në fjalë.



## ***Të gjitha rastet gjyqësore janë të bashkangjitura në Shtojcën 1, të këtij dokumenti.***

### **Sfidat gjatë vitit 2019**

Në fillim të vitit 2019, respektivisht në kohën e ardhjes së Bordit të ri të Drejtorëve dhe të Kryeshefit të ndërmarrjes, gjendja në Ndërmarrje nuk ishte e mirë. Nuk dihej fare as numri i përgjithshëm i punonjësve, e as numri i saktë i punonjësve aktivë. Rrjedhimisht, një prej sfidave kryesore fillimisht ishte riorganizimi, ristrukturimi dhe ri sistemimi i punonjësve në bazë të rregullores për sistematizim dhe riorganizim të vendeve të punës, e cila u miratua nga Bordi i ri i Drejtorëve.

Një sfidë tjetër e madhe e Ndërmarrjes ishte edhe ballafaqimi me procese e me lëndë gjyqësore, kryesisht të natyrës civile, me konteste mbi marrëdhënien e punës. Pra, me lëndë të trashëguara nga e kaluara, të cilat ishin rezultat i punësimeve dhe sistematizimeve të punonjësve sipas preferencave personale, etj.

### **Çka do të përmirësohet gjatë vitit të ardhshëm?**

Është i domosdoshëm avancimi i mëtutjeshëm i funksionalizimit të Arkivit, përfshirë edhe qasjen sa më të lehtë të stafit në dokumente.

Kjo gjë planifikohet të arrihet nëpërmjet digjitalizimit të arkivit, dhe me një koordinim dhe komunikim sa më të mirë, të shpejtë e transparent ndërmjet sektorëve të ndryshëm të ndërmarrjes (burimet njerëzore, arkivi dhe zyra ligjore), me qëllim të përmirësimit të rrjedhës së procesit të punës.

Gjatë vitit 2020 planifikohet edhe hartimi dhe miratimi i rregulloreve të reja, si p.sh. i Rregullores për Shëndetin dhe Mbrojtjen në Punë, plotësim/ndryshimi i Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës (me të cilën synohet që punonjësit të sistemohen në bazë të shkollimit dhe të meritave), Rregullorja për Kriteret e Pagave dhe Nivelimin e Pagave, etj.

Gjatë vitit kemi pasur 23 përfaqësime, shkresa etj, të ndryshme gjyqësore. Zyra ligjore bazuar në aktvendimet e gjykatës, respektivisht aktgjykimeve, ka ndërmarrë hapa procedural si përgjigje ne padi dhe ushtrim të ankesës.

Gjatë vitit 2019, kemi një rast i cili ka marrë formën përfundimtare të aktgjykimit, pas shterjes së të gjitha mundësive ligjore mbi të drejtën e ankesës. Detyrimi i Ndërmarrjes sipas Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit ka qenë, që në emër të shpërblimit jubilar, punëtores tashmë të pensionuar, t'i paguhen tri paga.

Ndërmarrja në këtë rast ka vepruar sipas Aktgjykimit dhe e ka përmbushur obligimin e saj ligjor.

Po në këtë kontest, disa prej ish-punëtorëve të Ndërmarrjes, nga Gjykata Themelore, iu është aprovuar kërkesa për realizimin e tri pagave në emër të shpërblimit jubilar. Zyra ligjore në harmoni me rregullat e procedurës civile ka ushtruar të drejtën e ankesës dhe aktgjykimet i kemi kundërshtuar në Gjykatën e Apelit. Deri me tani nuk kemi pranuar përgjigje nga Gjykata në fjalë.

Lidhur me kërkesën dhe realizimin e tri pagave në emër të shpërblimit jubilar kemi pranuar vetëm një aktgjykim refuzues nga Gjykata Themelore në Prishtinë. Të gjitha rastet gjyqësore janë të bashkangjitura në Shtojcën 1, të këtij dokumenti.

## Sfidat

Gjendja në fillim të vitit 2019 nuk ka qenë e mirë. Numri i punëtorëve si dhe numri i saktë i punëtorëve aktivë nuk ka qenë i ditur. Një prej sfidave kryesore ka qenë riorganizimi, ristrukturimi dhe sistemimi i punëtorëve në bazë të rregullores për sistematizim dhe riorganizim të vendeve të punës, miratuar nga Bordi i Drejtorëve të NPL-së.

Sfidë tjetër e Ndërmarrjes ka qenë ballafaqimi në procese gjyqësore me lëndë gjyqësore kryesisht të natyrës civile, konteste nga marrëdhënia e punës, lëndë të trashëguara nga e kaluara që kanë ardhur si rezultat i punësimeve dhe sistematizimeve të punëtorëve sipas preferencave personale.

## Çka do të përmirësohet gjatë vitit të ardhshëm

E domosdoshme për t'u përmirësuar është, funksionalizimi i Arkivit dhe qasja sa më e lehtë e stafit në dokumente. Pra, kjo, planifikohet të arrihet përmes digjitalizimit të arkivit. Po ashtu, me theks të veçantë do të jetë koordinimi si dhe komunikimi sa më i mirë dhe i shpejtë dhe transparent mes sektorëve të ndryshëm (burimeve njerëzore, arkivit dhe zyrës ligjore) me qëllim të përmirësimit të rrjedhës së procesit të punës.

Gjatë vitit 2020, planifikohen të nxirren rregullore të reja në fusha të ndryshme si p.sh. përpilimi i Rregullores për Shëndetin dhe Mbrojtjen në Punë, plotësim/ndryshimi i Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës me të cilën synohet që punëtorët të sistemohen në bazë të shkollimit të tyre dhe të meritokracisë, Rregullorja për Kriteret e Pagave dhe Nivelimin e Pagave etj.

## 5. Financat

Shërbimi i peronizimit është aktivitet primar ekonomik për gjenerimin e të hyrave të NPL Stacioni i Autobusëve SH. A. Prishtinë. Shërbim tjetër i drejtpërdrejtë i Stacionit është edhe shitja e biletave të udhëtimit për relacione të ndryshme. Për këtë shërbim, Ndërmarrja bën marrëveshje me operatorët dhe përfiton një komisionin (10%), të cilin e ndalë nga shitja e biletave, si dhe një tarifë fikse prej 0.50 euro për secilën biletë të shitur, në emër të provizionimit të shërbimeve të Stacionit. Aktivitet tjetër i rëndësishëm është edhe shërbimi i parkingut për automjete të ndryshme, të cilat paguajnë në bazë të klasifikimit, në baza ditore, javore dhe mujore.

Në kuadër të Ndërmarrjes operojnë edhe lokalet afariste, të cilat lëshohen me qira për subjektet juridikë, duke gjeneruar kështu të hyra shtesë për ndërmarrjen. Gjatë vitit 2019 kanë qenë 24 biznese që operonin brenda lokaleve të Stacionit të Autobusëve. Bëhet këtu fjalë kryesisht për veprimtari të ndryshme hoteliere, apo për biznese të vogla individuale shërbyese apo tregtare.

Të hyrat tjera realizohen nga shërbimet e ruajtjes së valixheve të udhëtareve (Shërbimi i Gardërobës), dhe nga Shërbimi i Marketingut, megjithëse deri më tani Ndërmarrja është dëmtuar mjaft nga ky shërbim, ngase nëpërmjet një kontrate të përmbyllur nga menaxhmenti i kaluar, një kompanie të jashtme i është dhënë ekskluziviteti i menaxhimit të plotë të hapësirës së ndërmarrjes që është paraparë për reklama dhe marketing, në këmbim të një provizioni prej 10 % (përqind) që e merr Ndërmarrja. Që nga viti 2019 ndërkaq, falë lansimit të ueb-faqes së modernizuar të ndërmarrjes mundësohet që bizneset e ndryshme të promovojnë veprimtaritë e tyre aty, në këmbim të një shume të caktuar mujore apo vjetore për këtë shërbim – edhe pse ky shërbim sapo është iniciuar.

## Të hyrat

Të hyrat e përgjithshme të Ndërmarrjes gjatë vitit 2019 ishin 1,015,464.93 euro.

Pjesa më e madhe e këtyre të hyrave u realizuan nga shërbimi i peronizimit, i cili përbënë 51.92% të të hyrave të përgjithshme, ose 527,624.95 euro.

Paralelisht, nga lokalet dhe hapësirat e tjera afariste të lëshuara me qira, Ndërmarrja gjeneroi 22% të të hyrave, respektivisht 226,754.88 euro.

Veç kësaj, në vitin 2019 Ndërmarrja ka gjeneruar të hyra edhe nga këto aktivitete të saj:

- Nga parkingu 129,330.78 euro, ose 12.74%
- Nga shërbimi në portë 52,590.74 euro, ose 5.18%
- Nga shërbimet e Stacionit 47,630.19 euro, ose 4.69%
- Nga reklamat 380 euro, ose 0.04%
- Nga provizioni 30,096.46 euro, ose 2.96 %
- Nga gardëroba 136.43 euro, ose 0.01 %
- Nga hyrje-dalja 80.51 euro, ose 0.01 %
- Nga të hyrat e tjera (mjetet themelore) 839.99 euro, ose 0.08%

Me fjalë të tjera, në vitin 2019 ndërmarrja ka gjeneruar gjithsej 1,015,464.93 euro të hyra.

## Shpenzimet

Pjesën më të madhe të shpenzimeve në vitin 2019 e përbënin shpenzimet për pagat e punonjëseve, që kapin vlerën e 829,497.64 eurove, ose 83.82% të shpenzimeve të gjithmbarshme të ndërmarrjes.

Shpenzimet administrative paraqesin shpenzimet për shërbime të ndryshme dhe ato kapin vlerën e 15,847.88 eurove, gjegjësisht 1.58% të shpenzimeve të gjithmbarshme. Tutje, shpenzimet që ndërlidhen me komunikime, e ku përfshihen shpenzimet e telefonisë mobile dhe asaj tokësore janë 8,649.36 euro, respektivisht 0.86 % të shpenzimeve të përgjithshme. Shpenzimet vjetore për shërbime komunale kapën vlerën e 60,041.55 eurove, gjegjësisht 5.99% të totalit të shpenzimeve. Në këtë grup të shpenzimeve hyjnë faturat e rrymës, mbeturinave, ujit, etj.

Shpenzimet e mirëmbajtjes për vitin 2019 ishin 44,591.96 euro, ose 4.45% e shpenzimeve të përgjithshme. Ndërkaq, shpenzimet e tjera operative ishin në vlerë prej 42,899.96 euro, ose 4.28% e totalit të shpenzimeve të ndërmarrjes. Në këtë grup të shpenzimeve hyjnë shpenzimet e kontrollimit sistematik të punonjësve, të pajisjes së punonjëseve me gardërobe, shpenzimet e vlerësimit dhe të matjes së lokaleve dhe hapësirave tjera afariste, blerja e pajisjeve të teknologjisë informative, etj.

Rrjedhimisht, rezulton se shpenzimet e përgjithshme vjetore të ndërmarrjes ishin 1,001,528.35 euro gjithsejtë.

Po ashtu, vlen të theksohet edhe ajo se Shpenzimet e zhvlerësimit paraqesin një pjesë të madhe të shpenzimeve, të cilat ndikojnë në pasqyrat financiarë të Ndërmarrjes.

Zhvlerësimi i ndërtesës, inventarit dhe i pajisjeve për vitin 2019 kapte vlerën e përgjithshme prej 156,742.82 eurove.

## Bilanci përfundimtar

Në vitin 2019 Ndërmarrja ka operuar me fitim operativ (para zhvlerësimit) prej 13,852.66 eurove. Nga ana tjetër, edhe gjatë vitit 2019, si rezultat i vlerës së zhvlerësimit të ndërtesës, aseteve, dhe inventarit Ndërmarrja paraqiti humbje prej 64,518.75 euro.

## Krahasimi me vitin paraprak 2018

Gjatë vitit 2018, përveç shërbimeve që funksionuan edhe gjatë vitit 2019, Ndërmarrja posedonte edhe shërbimin e Tripod-it, i cili asokohe gjeneroi 101,581.41 euro. Mirëpo, ky shërbim ishte tejet i kontestuar nga operatorët dhe udhëtarët, prandaj edhe u largua në fund të vitit 2018, menjëherë pas ndërrimit të Menaxhmentit dhe shkarkimit të Bordit paraprak.

Përkundër kësaj, nëse krahasohen të hyrat e vitit 2019 me ato të vitit 2018 vërehet një rritje e të hyrave pothuajse në të gjitha shërbimet e ofruara nga Ndërmarrja, gjë që rezulton me të hyra më të mëdha të përgjithshme të ndërmarrjes në vitin 2019.

Pershkrimi	Te Hyrat 2019		
	Viti 2018	Viti 2019	Diferenca 2019-2018
Sherbimi i stacionit	24,597.20	47,630.19	23,032.99
Parkingu	115,493.45	129,330.78	13,837.33
Provizioni	35,040.54	30,096.46	(4,944.08)
Peronizimi	557,203.96	527,624.95	(29,579.01)
Sherbimi ne porte	15,332.25	52,590.74	37,258.49
Garderoba	0.84	136.43	135.59
Hyrja dalja	159.41	80.51	(78.90)
Reklama	114.41	380.00	265.59
Plat 0.10	60,860.49	-	(60,860.49)
Plat 0.50	15,380.93	-	(15,380.93)
Plat 1.00	23,944.03	-	(23,944.03)
Plat 5.00	228.80	-	(228.80)
Plat 16	907.85	-	(907.85)
Plat 18	259.31	-	(259.31)
Mujore 20 dhe 25 furnizues	3,610.87	-	(3,610.87)
Te hyra Auto Shkollat muj 13.50 dhe	19,163.10	-	(19,163.10)
Te hyrat nga 3.00	3,806.39	-	(3,806.39)
Te hyrat nga mbyllja e avansit	11,408.68	-	(11,408.68)
<b>Gjithsejt shërbimet</b>	<b>887,512.51</b>	<b>787,870.06</b>	<b>(99,642.45)</b>
Te hyrat nga qirate	213,796	226,754.88	12,958.88
Te hyrat tjera (mjetet themelore)	0	839.99	839.99
<b>Grand total</b>	<b>1,101,308.51</b>	<b>1,015,464.93</b>	<b>(85,843.58)</b>

### \* Rubrikat me të verdhë janë të hyrat e realizuara nga Tripodi gjatë vitit 2018

Në fakt, po qe se krahasohen detajisht të gjitha të dhënat financiare për vitet 2018 dhe 2019, qartazi vërehet një ulje e dukshme e shpenzimeve të gjithmbarshme, duke filluar që nga shpenzimet e pagave, ulja e shpenzimeve të paligjshme të paguara për transportin e punonjësive për në ndërmarrje dhe anasjelltas, ulja e shpenzimeve të ndryshme administrative, ulja e shpenzimeve të telefonisë mobile he tokësore, ulja e shpenzimeve komunale, e kështu me radhë.

Paralelisht, është vërehet se ka pasur një rritje të shpenzimeve të shërbimeve të mirëmbajtjes dhe të shpenzimeve operative, të cilat në fakt paraqesin investimet e bëra nga ana e Ndërmarrjes me qëllim të krijimit të një ambienti sa më të pastër dhe më të favorshëm për klientët dhe për vetë punonjësit e Ndërmarrjes.

Shpenzimet 01.01.2019-31.12.2019	Viti 2018	Viti 2019	Differenca 2019-2018
Shpenzimet e pagave	893,308.22	829,497.64	(63,810.58)
Shpenzime administrative	18,185.20	15,847.88	(2,337.32)
Shpenzime e telefonit	10,694.18	8,649.36	(2,044.82)
Shpenzimet e rrymes, ujit, mbeturinave	68,976.90	60,041.55	(8,935.35)
Shpenzimet e mirembajtjes	11,351.82	44,591.96	33,240.14
Shpenzime tjera operative	29,121.59	42,899.96	13,778.37
<b>Totali I shpenzimeve op dhe adm</b>	<b>1,031,637.91</b>	<b>1,001,528.35</b>	<b>(30,109.56)</b>
Zhvleresimi I ndertesave	225,246.60	56,087.53	(169,159.07)
Zhvleresimi I inventarit dhe I paisjeve	19,942.18	22,283.88	2,341.70
Zhvleresimi I aseteve	245,188.78	78,371.41	(166,817.37)
<b>Gjithsejt shpenzimet</b>	<b>1,276,826.69</b>	<b>1,079,899.76</b>	<b>(196,926.93)</b>

## 6. Operativa

### Të arriturat

Ndër qëllimet kryesore të Ndërmarrjes gjatë vitit 2019 ishte përmirësimi i kushteve të operimit për të gjithë klientët që shfrytëzojnë Stacionin e Autobusëve. Andaj, sipas sugjerimit të aksionarëve të ndërmarrjes, dhe me qëllim që udhëtarët dhe auto transportuesit të kenë qarkullim dhe qasje sa më të lehtë janë larguar plotësisht Tripodi dhe rrethojat brenda Stacionit, të vendosura vite më parë nga menaxhmenti i kaluar i Ndërmarrjes.



Tutje, me qëllim të lehtësimit të qarkullimit të automjeteve, është bërë edhe ndërrimi dhe instalimi i softuerit të ri të ndërmarrjes, i cili mbikëqyrë dhe operon në mënyrë digjitale të gjitha hyrje-daljet e automjeteve në stacion.

Po ashtu është bërë ndarja dhe rregullimi i plotë i dy zyrave të reja - njëra për nevojat e garde, e tjetra për nevoja të Policisë së Kosovës.

Është bërë rregullimi i ndriçimit komplet të brendshëm dhe të jashtëm, janë vendosur shportat e mbeturinave, janë rregulluar parqet e Stacionit, janë mbjellë drunj dhe lule shumëvjeçare, dhe janë vendosur zhardinjera të reja. Të gjitha këto e kanë zbukuruar gjithë ambientin në hollin e Ndërmarrjes, si dhe gjithë pjesën e jashtme të objektit dhe oborrit të Stacionit.

Po ashtu, është bërë lyerja e të gjitha shtyllave të jashtme pranë peronave, lyerja e hapësirës së brendshme të hollit të Stacionit si dhe lyerja e Sporteve, gjë që i ka dhënë një pamje të re Stacionit.

Me qëllim të mbrojtjes së këmbësorëve, është investuar në ishullin ndarës të rrugës, gjegjësisht në vendosjen e rretës ndarëse, si dhe në mbjelljen e bimëve shumëvjeçare që do të shërbejnë si pengesë natyrore, si dhe do të shtojnë hapësirën e gjelbëruar në ndërmarrje.

Me qëllim që të kemi ujë të mjaftueshëm për nevojat higjienike dhe të ndërmarrjes (si për pastrim, ujitje të hapësirave gjelbëruese, etj), është bërë hapja e dy bunarëve brenda oborrit të Stacionit.



Tutje, është investuar në ndarjen e dy lokaleve të reja, në të dy anët e hyrjes kryesore për të ndërtesës së Stacionit, dhe është bërë një investim në hapësirën e katit të dytë, mbi hyrjen kryesore, nga i cili do të aktivizohet një sipërfaqe prej mbi 250 metra katrorë për qiradhënie.

Sportelet që qëndronin të pashfrytëzuar janë riparuar dhe lëshuar me qira, duke mundësuar kështu që, bashkë me dy lokalet e reja që u përmendën më sipër, të fillojmë me realizimin e të hyrave më të mëdha për ndërmarrjen.

Janë ndërtuar dy kabina për laurist, si dhe një shtëpizë për pagesën e parkingut. Këto dy investime kanë mundësuar një mbikëqyrje më të mirë të parkingut, por edhe një mundësi më të lehtë dhe më të afërt pagese për konsumatorët për shërbimin e pranuar.

Është bërë vendosja e kamerave shtesë në pjesën e jashtme dhe të brendshme të Ndërmarrjes, të cilat përveç që kanë ndikuar në rritjen e sigurisë së gjithmbarshme, kanë ngritur edhe vetëdijen e punonjësve për të ofruar shërbime më të mira për të gjithë konsumatorët.

Pas një kohe të gjatë është bërë dezinfektimi i hollit të Ndërmarrjes, si dhe deratizimi i gjithë hapësirës.

Me qëllim që zyrat e ndërmarrjes të mos shërbejnë më për ushqim, e as mos kundërmojnë në ushqime, është ndarë një hapësirë e pashfrytëzuar për bufenë e re, e cila është pajisur me të gjitha elementet e nevojshme. Si rrjedhojë, punonjëset e Ndërmarrjes nuk kanë më nevojë të ushqehen nëpër zyre, por këtë tani e bëjnë në bufenë e Ndërmarrjes.

Të gjitha zyrat e administratës dhe të operativës janë pajisur me pajisje aklimatizimi, ndërkohë që për nevoja të takimeve me punonjës është ndarë dhe aranzhuar një hapësirë e re, e cila tashmë shfrytëzohet për nevojat e takimeve të ndryshme të Ndërmarrjes.



Meqë ndërmarrja ende nuk është e lidhur me Termokos, si zgjidhje e përkohshme është bërë furnizimi me ngrohëse mobile, të cilat kanë krijuar një ambient sadopak të ngrohtë për udhëtarët që presin autobusët në hollin e Stacionit. Në ndërkohë menaxhmenti i ndërmarrjes është në bisedime me Termokosin për kyçjen e ndërmarrjes në sistemin e ngrohjes së qytetit.


Me qëllim të rritjes së nivelit të komunikimit të brendshëm dhe të sigurisë mes pikave të ndryshme dhe personave kompetent në Ndërmarrje, është bërë pajisja me radiolidhje dhe me telefona mobilë e personave përgjegjës.

Po ashtu, meqë faturimi i përbashkët i ujit, mbeturinave dhe rrymës ka qenë një tjetër problem i trashëguar, menaxhmenti tashmë ka arritur që të bëjë ndarjen e faturave të lokaleve për pagesë të mbeturinave, në ndërkohë që është në përfundim të punimeve për ndarjen e orëve të veçanta të rrymës për secilin biznes që operon brenda Ndërmarrjes. Gjithashtu, një kërkesë për ndarjen e ujëmatësve i është bërë edhe ndërmarrjes së ujësjellësit, por ende nuk ka një përgjigje të definuar nga atje.

## Linjat e udhëtimit

Gjatë vitit 2019 ka pasur gjithsejtë 142,108 linja të realizuara. Krahasuar me vitin paraprak (2018), kjo nënkupton një rritje prej 9%, gjegjësisht 12,735 linja më shumë.

Kjo rritje erdhi si rezultat i marrëveshjes së arritur me Shoqatën e Transportuesve Rrugor, i përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimeve në Stacion dhe i bashkëpunimit të stafit të Stacionit me Inspektoratin e Komunikacionit.



The screenshot shows a search interface with a 'Destinacioni' input field and a 'Kërko' button. Below it, there are buttons for 'Ndërrubane' and 'Ndërkombëtare'. The main content is a table titled 'Orari i linjave' with the following data:

Destinacioni	Kompanija	Koha e nisjes	Peroni
AEROPORT	TRAFIKU URBAN	⌚ 03:00	PERONI NDIHMES
AEROPORT	TRAFIKU URBAN	⌚ 04:00	PERONI NDIHMES
AEROPORT	TRAFIKU URBAN	⌚ 05:00	PERONI NDIHMES
AEROPORT	TRAFIKU URBAN	⌚ 06:00	PERONI NDIHMES
GJILAN	BLERI-COMERC	⌚ 06:30	5
MITROVICË	QËNDRESA	⌚ 06:30	4
FERIZAJ	BLERI-COM	⌚ 06:45	7
DRENAS - SKENDERAJ	MEMI REISEN SKENDERAJ	⌚ 06:45	3

## Sfidat gjatë vitit 2019

Kemi pasur dhe ende kemi problem me një pjesë të qytetarëve, për sa i përket pagesës së parkingut, sepse të njëjtit ende nuk e kuptojnë si duhet se ku duhen bërë pagesat. Problem tjetër mbesin edhe laurat, të cilat nganjëherë nuk funksionojnë si duhet. Me sa duket, problemi qëndron te lexuesit e barkodëve të biletave (skanerët) dhe te mos leximi i duhur i targave nga ana e kamerave për shkak të ndriçimit të dobët, gjë që shpeshherë e stagnon punën.

Numri i kufizuar i peronave dhe hapësira e kufizuar e parkingut kanë qenë ndër sfidat tjera të rëndësishme me të cilat është ballafaquar Stacioni, dhe për këtë problem menaxhmenti aktualisht po analizon gjetjen e zgjidhjeve të mundshme.

## Çka do të përmirësohet gjatë vitit të ardhshëm?

Për vitin e ardhshëm mendohet të shtohet numri i punonjësve të sigurimit dhe të laurave (sepse është vërejtur mungesa e tyre), pastaj të përforcohet ndriçimi dhe të bëhet vendosja e kamerave shtesë (këto kanë qenë kërkesa të përsëritura për evitim dhe zbulimin e dëmtimeve, vjedhjeve apo rrahjeve). Veç kësaj, nevojitet trajnim shtesë për punonjësit e sigurimit dhe laurave.

## Planifikimi i aktiviteteve të nevojshme deri në fund të vitit 2020:

- Digjitalizimi dhe shitja e biletave të sofistikuara;
- Pajisja me gardërobe të re për punonjësit në operativë;
- Krijimi dhe futja në përdorim i një aplikacioni të ri financiar dhe të kontabilitetit, me lidhje me modulën e burimeve njerëzore;
- Ngrohja qendrore me Termokos, ose opsioni me pelet;

- Rregullimi i ËC-së publike brenda Stacionit;
- Krijimi i pikës së re të monitorimit dhe kontrollit, bashkë me pajisjet e reja përcjellëse (kamerat e reja);
- Zgjerimi i hapësirës së parkingut për automjete dhe autobusë;
- Vazhdimi i gjelbërimit dhe mbjelljes së drunjve me qëllim të uljes së ndotjes;
- Si ide shtesë, gjenerimi i rrymës nga panelet diellore;
- Vendosja e objekteve të vogla mobile ekologjike në oborrin e Stacionit, nga të cilat do të mund të gjenerohej qira.

## 7. Prokurimi

### Të arriturat

Gjatë vitit të kaluar, Zyra e Prokurimit ka zhvilluar gjithsejtë 97 procedura dhe aktivitete të prokurimit, me vlerë të përgjithshme prej 107,165.59 eurove. 88 prej tyre ishin aktivitete me vlera minimale, 7 me vlera të vogla dhe 2 me vlera të mesme.

Po ashtu, për shkak të vonesave në kryerjen e punimeve është bërë një (1) ndërprerje e kontratës, dhe janë bërë tri (3) anulime të tenderëve, për arsye të mos përbushjes së kriteve të kërkuara.

### Sfidat gjatë vitit 2019

Sfida kryesore me të cilën është ballafaquar Zyra e Prokurimit është mos planifikimi i mirëfilltë i procesit të prokurimit nga njësitë kërkuuese, gjë që pastaj ka rezultuar me një numër të madh të procedurave me vlerë minimale.

### Çka do të përmirësohet gjatë vitit të ardhshëm?

Do të synohet që të arrihet planifikimi me kohë i kërkesave dhe i nevojave nga njësitë kërkuuese, si dhe eliminimi i kërkesave emergjente (pra, i procedurave me vlerë minimale).

## 8. Marrëdhëniet me publikun

### Të arriturat

Destinacioni	Kompania	Nrja	Person
LIRIAN	EDISONI	08:55	14
Aersport	Traiku Urban	09:00	Personi ndihmes
GAAROVE	METI-COMERC-H	09:00	9
FERIZAJ	DRITONI-BESEN	09:00	6
GJILAN	DALINA	09:00	4
ORINAK	VËLLZORIT THAQI	09:00	16
MITROVICE	LABINOTI	09:00	3
PIJE	BERDYNA TOURS	09:00	1
KURNE-ISTOG	BALA	09:00	2

Roli i Zyrës për Marrëdhënie me Publikun në vitin 2019 ishte iniciimi nga themeli i ndërtimit të reputacionit pozitiv të Ndërmarrjes. Ndonëse në vitin e parë të operimit, Zyra kë bërë publikimin e informacioneve të sakta dhe të nevojshme, me qëllim të plotësimit të nevojës për një informim të plotë dhe të saktë publik.

Transparenca gjatë vitit 2019 në Ndërmarrje ka qenë më e larta ndonjëherë, gjë që është arritur përmes informimit të klientëve dhe publikut për punën dhe aktivitetet e ndërmarrjes, por edhe falë përditësimit të vazhdueshëm të informatave teknike në ueb-faqen e ndërmarrjes.



Ri dizajni komplet dhe plotësimi i ueb-faqes zyrtare me informacione të plota në të tri gjuhët (shqipe, serbe, angleze - janë përkthyer 63 dokumente) ka mundësuar funksionimin e pandërprerë dhe dokumentimin e sukseseve të ndërmarrjes, duke rritur kështu edhe numrin e kërkesave për informacione rreth shërbimeve që ofron Stacioni.

Paralelisht, nëpërmjet rrjeteve sociale (Facebook, Instagram) ndërmarrja ka publikuar konkurse, dokumente, artikuj, foto dhe video shoqëruese, etj.

### **Sfidat gjatë vitit 2019**

Viti 2019 ishte mjaft sfidues për Zyrën për Marrëdhënie me Publikun (ZMP), ngase ishte viti i parë i funksionimit të saj. Megjithëkëtë, zyra ka publikuar nëpërmes ueb-faqes zyrtare dhe rrjeteve sociale dokumentacion dhe informacione të bollshme për publikun, duke ofruar kështu informata të shpejta e të duhura për rrisitë dhe shërbimet që ofron Stacioni.

### **Çka do të përmirësohet gjatë vitit të ardhshëm?**

Përkundër evoluimit të saj Zyra e Marrëdhënieve me publikun ka edhe shumë punë për të bërë.

Në periudhën në vazhdim synohet të punohet më shumë në plasimin e informatave tjera relevante për publikun, por edhe që, në bashkëpunim me Zyrën e Marketingut e shitjes të punohet në aktivizimin eventual të shërbimeve online të shitjes së biletave dhe kontaktit me klientë, në rritjen e të hyrave nga shitja e hapësirave reklamuese, etj. Për arritjen e këtyre objektivave, Zyra do të ketë nevojë për trajnime shtesë në lëmin e komunikimit me publikun dhe mediave, në mënyre që avancoj tutje në menaxhimin e rrjeteve sociale, marketingut dhe informacioneve në përgjithësi.

## **9. Burimet Njerëzore**

### **Te arriturat**

Gjatë vitit 2019, nëpërmjet konkurseve publike u plotësuan postet e zyrtarëve më të lartë të Ndërmarrjes, që nga Kryeshefi Ekzekutiv i ndërmarrjes (proces ky i mbikëqyruar nga përfaqësuesit e Ambasadës Britanike në Kosovë), ZKFTH-ja e deri tek Sekretari Korporativ i ndërmarrjes.

Në ndërkohë, tashmë është plotësuar edhe pozita e vakante e Auditorit të Brendshëm të ndërmarrjes – pas mos vazhdimit të kontratës si zyrtarit të kaluar, për shkak të mos efikasitetit të plotë të tij në këtë post.

Po ashtu, gjatë vitit të kaluar Ndërmarrja angazhoi edhe tre (3) këshilltarë për çështje të ndryshme, për kohë të caktuar dhe me kontrata për shërbime. Këto angazhime ndodhën ngase Ndërmarrja asokohe pati mungesë të stafit profesional për çështjet me rëndësi të veçantë për Ndërmarrjen (ekspertë për çështje juridike dhe të financave).

Vlen të përmendet se, në vitin 2019 kanë ndodhur tri pushime nga puna, të bazuara në procedura ligjore dhe të realizuara përmes komisionit disiplinor; bëhet fjalë për një ndërprerje të marrëdhënies së punës për për shkak të migrimit të punonjësit, për një shkëputje vullnetare të kontratës për shkak të migrimit, dhe për një punonjës që kërkoi pensionim të parakohshëm.

Pas nxjerrjes së Rregullores së re për sistemim të vendeve të punës, janë bërë 45 ri sistemime të punonjësive nëpër vende të ndryshme të punës.

Nga nëntëdhjetekatër (94) punonjës, sa ka aktualisht Ndërmarrja, dyzetekatër (44) i kanë shfrytëzuar pushimet mjekësore, duke u bazuar në atë se si këtë çështje e përcakton Ligji i

Punës. Krahasuar me vitet e mëparshme kjo përbën një rënie drastike të shfrytëzimit të pushimit mjekësor nga ana e punonjëseve të ndërmarrjes.

Tre (3) punonjëse kanë shfrytëzuar pushimet e lehonisë, ndërkaq dy (2) punonjës pushimin pa pagesë. Njëri prej tyre e ka ndërprerë edhe marrëdhënien e punës, për shkak se ka migruar jashtë vendit.

Gjatë vitit, shtatë (7) raste janë proceduar nga komisioni disiplinor. Në dy (2) raste ka ndodhur shkëputja e marrëdhënies së punës. Po ashtu, ka pasur një rast (1) të uljes në detyrë, janë shqiptuar dy vërejtje me shkrim dhe është bërë një pezullim i procedurës disiplinore për shkak të mungesës së provave.

Për herë të parë gjatë vitit 2019 në Ndërmarrje është kryer kontrolli sistematik shëndetësor i të gjithë punonjëseve, një aktivitet ky që përndryshe ka qenë dhe është i obligueshëm me ligj.

Me qëllim të ngritjes profesionale dy (2) punonjës kanë ndjekur trajnime profesionale.

Po ashtu, gjatë vitit të kaluar janë bërë përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e kontrollit dhe monitorimit të punës që punonjësit e kryejnë në ndërmarrje. Për këtë qëllim është instaluar sistemi i ri multifunksional i zyrës së burimeve njerëzore, i cili përmes ëasjes online ndikon në ngritjen e cilësisë së punëve në kuadër të departamentit. Sistemi i ri bën kontrollimin e hyrje-daljeve në kohë reale, përdorimin e pushimeve të ndryshme, punonjësve u mundëson ngritjen e kërkesave të ndryshme drejtuar departamentit të burimeve njerëzore, etj. Gjithashtu, sistemi mundëson edhe kalkulimin e rrogave të punonjëseve, një funksion që me parë nuk ka qenë pjesë e burimeve njerëzore. Ky sistem i instaluar dëshmon për rolin e teknologjisë informative në përmirësimin e proceseve të punës.

Zyra e Burimeve Njerëzore përveç punës së rregullt të saj, ishte pjesë e koordinimit të punëve në çështje të ndryshme me interes për ndërmarrjen, që tani kryhen nga komisione të ndryshme, si p.sh. Komisioni për Paga, Komisioni për Verifikimin të Stazhit të Punës, Komisioni për Shpërblimin e Punonjëseve të dalluar; si dhe ka menaxhuar projektin për furnizimin me uniforma përkatëse të punonjësve në poste të operativës.

### **Sfidat gjatë vitit 2019**

Gjatë vitit të kaluar Zyra e Burimeve Njerëzore është ballafaquar sfida të shumta. Njëra prej tyre ishte numri i pamjaftueshëm i punonjësve të kualifikuar në kohën kur udhëheqësja e Zyrës ishte në pushim të lehonisë.

Tutje, për shkak të ndërrimeve të shpeshta të vendeve të punës së të punësuarve, gjendja e regjistrit të punonjëseve nuk ishte e mirë. Për më tepër, as sistemet e kontrollit dhe monitorimit nuk funksionuan si duhet, e as organizimi i punëve nuk ishte në nivel të kënaqshëm. E gjithë kjo erdhi i pasojë e asaj se Zyra e Burimeve Njerëzore dhe roli i saj ishte minimizuar dhe anashkaluar për një periudhë të gjatë kohore.

### **Çka do të përmirësohet gjatë vitit të ardhshëm?**

Do të vazhdohet me përmirësimin e vazhdueshëm të proceseve të punës në kuadër të departamentit. Pritet që sistemi online për burime njerëzore të pasurohet edhe me aplikacionin i cili do të mundësoj organizimin e orareve të punonjëseve në operativë në mënyrë automatike me qëllim të evitimit të ndonjë keqpërdorimi të mundshëm.

Po ashtu do t'i kushtohet rëndësi e veçantë ngritjes së kapaciteteve të punonjëseve përmes organizimit të trajnimeve për punonjëse në fushat ku ata kanë më së shumti nevojë. Teknologjia informative, pra përdorimi i kompjuterit dhe aplikacioneve të MS Office do të jetë qëllimi kryesor në aftësimin e punonjëseve gjatë vitit 2020. Trajnimet parashihen të organizohen nga stafi profesional i Ndërmarrjes.

## 10. Digjitalizimi

### Të arriturat

Gjatë vitit 2019 në Ndërmarrje janë bërë ndryshime të shumta në fushën e Teknologjisë Informative. Kjo, me qëllim që ndërmarrja të jetë në hap me zhvillimet aktuale në sektorin e Teknologjisë Informative dhe me aplikimin e saj në proceset e punës, në mënyrë që t'iu afrohet kompanive të mëdha për sa i përket menaxhimit dhe ruajtjes së të dhënave, funksionimit të sistemit të digjitalizimit, dhe të asaj që teknologjia informative të jetë pjesë përbërëse e menaxhimit të proceseve të punës.

Gjatë vitit, të gjithë punonjësët e ndërmarrjes janë pajisur me kompjuterë.

Pjesa me e madhe e pajisjeve të TI-së (kompjuterë, serverë, monitorë, etj) janë blerë të përdorura, për shkak të kapaciteteve të kufizuara financiare të Ndërmarrjes.


### Sistemi i digjitalizimit

Është zëvendësuar komplet sistemi i digjitalizimit, që ka funksionuar përmes leximit të RFD kartelave, ndërkohë që tani funksionon me "Face Recognition", gjegjësisht me lexim të targave.

Sistemi i ri ka ndikuar në uljen e madhe të mundësisë së keqpërdorimeve, që automatikisht nënkupton edhe rritjen e të hyrave. Secila hyrje-dalje evidentohet, dhe ato të gjitha janë faktike, me foto, dhe ruhen në platformën e digjitalizimit.

### Dhoma e Serverit (Server Room)

Para



Pas



Është bërë rregullimi i kabllimit, gjegjësisht renovimi i rretit. Janë blerë pajisjet e nevojshme, si switch-at e rinj dhe mikrotik. Është bërë një ndërrim i madh i dhomës së serverit, meqë e njëjta ka qenë në gjendje kaotike.

Falë furnizimit me pajisjet e përmendura është mundësuar monitorimi i vazhdueshëm dhe në mënyrë të lehtë.

### Blerja e PC-ve

Është intervenuar edhe në rregullimin e centralit telefonik.

Është punuar në rregullimin e kabllimit të centralit, dhe janë shtuar numra të rinj telefonik të nevojshëm për ndërmarrjen.

Gjithashtu, është aktivizuar edhe sistemi PBX, dhe është blerë një sekretare automatike telefonike.

### Linjë e re e internetit për laurat 1 dhe 2 nga Posta e Kosovës

Përveç ofruesit të internetit Telkos, është bërë kabllim i ri me fibër optik nga ana e Postës së Kosovës, nga dhoma e serverit deri tek laura 1 dhe laura 2, në mënyrë që ndërmarrja të ketë dy operatorë që ofrojnë internet, në rast të rënies së furnizimit me internet nga njëri provajder të jetë edhe opsioni tjetër – gjë që nuk lejon dështimin e sistemit të digjitalizimit.

I gjithë kabllimi i ri është bërë përmes gypave nëntokësor që janë vendosur për këtë qëllim.

### Kamerat

Janë bërë disa ndryshime në infrastrukturën e kamerave, gjegjësisht janë shtuar kamerat për arsye të një sigurie më të lartë. Me shtimin e hapësirës së memories tani mund të ruhen të dhënat rreth një muaj. Janë shtuar njëmbëdhjetë kamera, dy prej të cilave tek garderoba, një tek koordinatoret, një në korridorin tek dhoma e serverit, një tek kuzhina, tri tek sportelet, dy në korridorin e katit të dytë të administratës, dhe një tek shtëpiza për pagesa. Gjithashtu, disa kamerave iu janë ndërruar vendet, në bazë të kërkesave.

### Krijimi i ueb-faqes së re

Është bërë publikimi në ueb-faqe i të gjitha dokumenteve me rëndësi, si: ankandet, raportet, kontratat, lajmet ditore, konkurset, rregulloret, urdhëresat, etj. Të gjitha këto janë kryer me sukses dhe në kohë të shpejtë.

### Mirëmbajtja e kompjuterëve, printerëve dhe pajisjeve tjera teknologjike

Është bërë mirëmbajtja, formatizimi ose instalimi i programeve për të gjithë kompjuterët e ndërmarrjes, qoftë në administratë apo nëpër sportele.

Gjithashtu, plotësimi me sukses i kërkesave të ndryshme ditore në bazë të nevojës, përfshirë mirëmbajtjen, instalimin apo rregullimin e printerëve të ndërmarrjes.

### **Sfidat gjatë vitit 2019**

Që nga fillimi i vitit 2019 ka pasur sfida të shumta, meqenëse investimet dhe përmirësimet e nevojshme kanë marrë shumë kohë.

Sfidë tjetër për Zyrën e TI-së ka qenë edhe ajo se shumë punonjës të ndërmarrjes nuk kanë poseduar fare kompjuterë, e as njohuri të nevojshme për funksionim sa më të mirë në komunikim, punë me programe të ndryshme, e as për eliminimin e problemeve.

Megjithatë, prioriteti kryesor i zyrës ka qenë rregullimi i dhomës së serverit, e cila ishte në një gjendje jo të mirë, meqë nuk i plotësonte fare kushtet e punës. Kabllimi ishte kaotik dhe mungonin shumë pajisje të nevojshme.

Sistemi i digjitalizimit u implementua nga kompania ESPARK, dhe bazohet në leximin e RFID kartelave në hyrje-dalje, tek laurat e ndërmarrjes.

Nga muaji mars 2019, është implementuar edhe sistemi i ri me "face recognition", i cili funksionon përmes leximit të targave. I tërë ky projekt ka marrë rreth 7 muaj deri në përfundimin e tij, meqenëse në laura është dashur të ndërrohen shumë pjesë harduerike, përderisa nga ana softuerike është instaluar një ueb-aplikacion tjetër.

Deri në adaptimin e plotë të sistemit ka pasur sfida të shumta, përfshirë këtu prishjet e ndryshme, dëmtimin e ndërmarrjes nga ana e klientëve që synonin të dilnin pa paguar, dëmet e shkaktuara nga kushtet lagështia, bora, era etj., e që ndikonin në mosfunksionimin e duhur të laurave, etj.

Investime janë bërë edhe në shtimin e numrit të kamerave dhe të memories, për të rritur kështu sigurinë dhe periudhën e ruajtjes së incizimeve për rreth një muaj.

## Çka do të përmirësohet gjatë vitit të ardhshëm?

Ajo që ka mbetur pa u realizuar në sistemin e digjitalizimit është unifikimi i gjithë sistemit, ngase sistemi i shitjes së biletave ende funksionon me sistemin e vjetër Espark. Realizimi i këtij projekti është paraparë të nisë në pjesën e parë të vitit.

Po ashtu do të ketë shtim të numrit të kamerave të sigurisë në hapësirat e jashtme të ndërmarrjes.

Digjitalizimi i arkivit ka filluar nga janari i vitit 2020.

Do të bëhet edhe eliminimi i problemeve me energjinë elektrike, meqë ky është shkaktari kryesor për bllokimin e sistemit të digjitalizimit.

Do të instalohet një mur (apo fire-ëall) i rrjetit të ndërmarrjes, në mënyrë që siguria të jetë më e lartë. Megjithëse është e kushtueshme, kjo gjithsesi është e nevojshme.

Po ashtu, është planifikuar të investohet në informimin direkt të klientit përmes teknologjisë. Kjo do të realizohet përmes një kompjuteri me touch/prekje, përmes të cilit udhëtarët do të kenë qasje në internet, gjegjësisht në ueb-faqen e Stacionit, ku do të mund të informohen për linjat e autobusëve.

Ideja e pagesës me POS për bileta ose parking, është mesë e nevojshme, meqenëse shumë udhëtarë të huaj (por edhe vendorë) paguajnë me kartela dhe jo me para të gatshme.

## 11. Auditimi i jashtëm

Menaxhimi i keq i ndërmarrjes nga ish-menaxhmenti, për vite me radhë, shihet nga bilancet negative dhe me humbje të vazhdueshme. Kjo e ka shtyrë Komisionin parlamentar për ndërmarrje publike që të merret me çështjen e problematikes së NPL Stacioni i Autobusëve SH. A. Prishtinë. Prandaj edhe është angazhuar Auditori i Përgjithshëm i Kosovës që të bëjë auditimet e rregullta të jashtme të ndërmarrjes.

Përkundër faktit që Ndërmarrja ka pasur auditorin e saj të brendshëm, performanca e auditorit ka qenë e dobët, ngase ka munguar një auditim i mirëfilltë i brendshëm nga personi zyrtar i angazhuar për këtë qellim.

Menaxhmenti i ri i Ndërmarrjes është ballafaquar me dy raporte të Auditimit. Njëri për vitin 2017, dhe tjetri për vitin 2018. Në të dy këto raporte janë paraqitur të gjetura të shumta, dhe janë dhënë rekomandimet për përmirësime.

Për dy këto periudha, pra edhe vitin 2017 edhe vitin 2018, janë dhënë gjithsejtë 37 rekomandime. 19 rekomandime për vitin 2017, dhe 18 rekomandime për vitin 2018.

Bordi i ri i Drejtorëve dhe Kryeshefi i ri i Ndërmarrjes kësaj problematikë i janë qasur me seriozitetin më të madh, dhe që nga fillimi i mandati të tyre kanë ndërmarrë masa konkrete për zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Si rrjedhojë, falë punës së palodhshme gjatë tërë vitit 2019, pothuajse të gjitha rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm janë plotësuar plotësisht, përveç disave që janë zbatuar pjesërisht dhe që pritet të zbatohen plotësisht gjatë vitit 2020.

Të interesuarit, Tabelën e detajuar me rekomandimet e Auditorit, dhe me zbatimet e përmbyllura nga ana e Stacionit mund ta kenë edhe në formë të shtypur.

## Shtojca 1: Rastet Gjyqësore

1. 02/531 dt.24.04.2019 - Aktvendim nga Gjykata Th.C.nr.2561/18 Isuf Maliqi.
2. 02/532, dt.24.04.2019 - Aktvendim Gjykata TH. C.nr.2559/18 Elez Gashi.
3. 02/533 dt.24.4.2019 - Aktvendim Gjykata TH.C.nr.2946/17 Tërheqje nga kërkesa Ylber Çitaku
4. 02/579 dt.02.05.2019 - Përgjigje në padi C.nr.2561/18 Isuf Maliqi
5. 02/580 dt.02.05.2019 - Përgjigje në padi C.nr.2559/18 Elez Gashi.
6. 02/653.dt.13.05.2019 - Ankesë për Gjykatë të Ap. C.nr.2549/19 Sami Ahmeti.
7. 02/732 dt.23.05.2019 - Aktgjykim nga Gjykata Th.C.nr. 2560/18 Mustafë Selimi.
8. 02/761 dt.27.05.2019 - Ankesë për Gjykatë të Ap.C.nr. Mustafë Selimi.
9. 02/937 dt.17.06.2019 - Aktgjykim nga Gjykata Th. C.nr.2559/18 Elez Gashi.
10. 02/957 dt.25.06.2019 - Ankesë për Gjykatë të Ap. C.nr.2559/18 Elez Gashi.
11. 02/986 dt.25.06.2019 - Aktgjykim refuzues nga Gjykata Th.C.nr.2558/18 Mustafë Doda.
12. 02/1026 Aktgjykim nga Gjykata Apelit aprovohet kërkesa e Xufe Kaqorraj. AC.nr.4397/18
13. 02/1108 dt.16.07.2019 Aktvendim nga Gjykata e Ap. AC.nr.1175/18 Refuzohet ankesa e NPL-së.
14. 02/1114 dt.18.07.2019 Aktvendim nga Gjykata Th.C.nr.1514/19 Adonis Shabani.
15. 02/1205 dt.25.07.2019 Aktvendim Nga Gjykata Th. C.nr.1252/19 Sami Ahmeti.
16. 02/1215 dt.26.07.2019 Aktgjykim nga Gjykata Th. C.nr.2561/18 Isuf Maliqi.
17. 02/1260 dt.31.07.2019 Përgjigje ne propozim për masë dhe përgjigje në padi. C.nr.1252/19 Sami Ahmeti.
18. 02/1259 dt.31.07.2019 Përgjigje në padi C.nr.1514/19 Adonis Shabani.
19. 02/31.07.2019 Ankesë për Gjykatë të Apelit C.nr.2561/18 Isuf Maliqi.
20. 20.02/2325 dt.12.12.2019 Aktvendim nga Gjykata Th.C.nr.2487/18 Mihrie Rexha.
21. 02/2326 dt.12.12.2019 Aktgjykim nga Gjykata Th.C.nr.1252/19 Sami Ahmeti.
22. 22.02/2367 dt.18.12.2019 Ankesë për Gjykatë të Ap. C.nr.1252/19 Sami Ahmeti.
23. 23.02/ 2406 dt. 24.12.2019 Përgjigje në padi C.nr.2487/18 Mihrie Rexha.

## Shtojca 2: Pasqyrat financiare (shpenzimet dhe te hyrat)

### Shpenzimet

Konto	Pershkrimi	viti 2018	viti 2019	diferenca 2019-2018
5100-1	Kostoja emallit te shitur	344.50	83.92	(260.58)
<b>510</b>	<b>KOSTO E MALLIT TË SHITUR</b>	<b>344.50</b>	<b>83.92</b>	<b>(260.58)</b>
5200-1	Shpenzimet e pagave neto	753,220.68	700,301.45	(52,919.23)
5200-2	Shpen. e tatimit në pag	55,009.82	50,209.79	(4,800.03)
5200-3	Shpen. e kontrib. nga punëtor	42,538.86	39,493.20	(3,045.66)
5200-4	Shpen. e kontrib. nga pundhën	42,538.86	39,493.20	(3,045.66)
<b>520</b>	<b>SHPENZIMET E PAGAVE BRUTO</b>	<b>893,308.22</b>	<b>829,497.64</b>	<b>(63,810.58)</b>
5300-9	Shpen. për Konkurse, shpallje		46.67	46.67
5330-1	Shpenz. e materi. për zyre	2,294.56	3,361.06	1,066.50
5330-2	Shpenzi e reprezentacionit	5,168.06	4,954.94	(213.12)
5330-3	Shpenz. derivateve RENO	841.90	1,188.36	346.46
5330-5	Shpenz. për gazet zyrtare	56.00	92.00	36.00
5330-6	Shpen. të bler. invent. paimz		60.93	60.93
5330-7	Shpen. për konkurse tendere	419.00	499.50	80.50
5330-8	Shpen. e pag. Avokatoris	1,881.00	1,296.00	(585.00)
5330-9	Perkthime, material ndryshme	25.00	200.00	175.00
5330-13	Shpenzi tjera-parking i vet		18.19	18.19
5330-14	Shpenzimet e pagesës së sallës	3,108.47		(3,108.47)
5330-16	shpenzimet për uj rugove	419.50		(419.50)
5330-16	Shpen. perkthime		630.00	630.00
5330-17	SHpenz. Derivate-KIA	651.98	1,129.31	477.33
5330-18	Shpenz. uji per piqe-adminis		507.73	507.73
5330-19	shpenz. për punëtori	3,172.17	40.00	(3,132.17)
5330-20	shpenz. derivat, koses barit	63.66	12.72	(50.94)
5330-21	shpenz. tiket per laura	83.90	83.90	-
5330-22	Shpenz. për aktivitet sporti		160.00	160.00
5330-23	Shpenz-vulat e ndermarrjes		125.00	125.00
5330-24	shpenzimet per byfe		456.91	456.91
5330-25	shpenz, kartela, logo, organo		741.66	741.66
5330-26	Shpenz. foto e perbashket		243.00	243.00
<b>533</b>	<b>SHPENZIMET ADMINISTRATIVE</b>	<b>18,185.20</b>	<b>15,847.88</b>	<b>(2,337.32)</b>

5340-1	Shpen.e telefonit 540 142	1,041.20	891.63	(149.57)
5340-7	Shpen.e telefonit 552 050	4.65	17.76	13.11
5340-8	Shpen.e telefonit -Drejtori	218.65		(218.65)
5340-9	Shpen.T.elipko të kontraktua	2,522.35	6,158.69	3,636.34
5340-10	Shpen.e internetit	1,078.54	759.64	(318.90)
5340-11	Shpen.telefo.në rreth	5,350.83		(5,350.83)
5340-12	shpenzimet e tel.Bordi	477.96		(477.96)
5340-15	Shpenz.e TV-s vjebre		83.90	83.90
5340-16	shpenz.tel,rreth Vala		737.74	737.74
<b>534</b>	<b>SHPENZIMET E TELEFONIT - ADMINISTRATIVE</b>	<b>10,694.18</b>	<b>8,649.36</b>	<b>(2,044.82)</b>
5360-1	Shpenzimet e rrymës	52,431.48	50,131.67	(2,299.81)
5360-2	Shpen.deriv.për gjenerator	1,412.94		(1,412.94)
5360-3	Shpenzimet e ujit	8,532.48	6,011.69	(2,520.79)
5360-4	Shpenzimet e mbeturinave	6,600.00	3,898.19	(2,701.81)
<b>536</b>	<b>SHPENZIMET E RRYMES,UJIT,MB</b>	<b>68,976.90</b>	<b>60,041.55</b>	<b>(8,935.35)</b>
5370-1	Shpen.e mirmbaj-rrymës	1,150.89	3,501.83	2,350.94
5370-2	Shpen.e mirmbajt.dyerve	1,058.55	1,130.32	71.77
5370-3	Shpen.e mirmbaj.dritareve	202.92	643.63	440.71
5370-4	Shpenz.e mirmbaj.hollit	82.14	1,462.65	1,380.51
5370-5	Shpen.e mirmbaj.rrugve	1,462.54	2,931.81	1,469.27
5370-6	Shpen.e mirmb.parkut	290.50	2,625.49	2,334.99
5370-7	Shpen.e mir.portave-laurave	771.36	3,241.55	2,470.19
5370-8	Shpe.e mirmb.aparateve elek	346.31	365.01	18.70
5370-9	Shpenz.e aparat kunder zjar	233.50	62.00	(171.50)
5370-10	Shpen.e mirmb.se programit	450.00	573.73	123.73
5370-11	Shpen.e mirmb.se veturës	561.95	850.33	288.38
512-12	Shpe.e mirmsë agregatit	221.20		(221.20)
5370-13	Shpe.e mirmb.maki.se barit		30.00	30.00
5370-18	Mirë mbajja e Tualeteve	108.64	134.27	25.63
5370-19	Mirë mbajt e Arkave fiskale	394.93	530.51	135.58
5370-20	Mirbaj.e zyres -	1,355.14	15,978.88	14,623.74
5370-23	Mirë mbaj.e kamerave	50.85	123.46	72.61
5370-24	Mirë mbajja e pushtave		105.93	105.93
5370-25	Mirëmbajja e nxemseve-Term	29.74	502.21	472.47
5370-27	Mirëmbajja e shenjave të komunikacionit	36.00		(36.00)
5370-29	Mirëmbaj.e gypave të ujsjel		45.50	45.50
5370-31	Mirëmb.e Kolicës		10.00	10.00
5370-32	Mirëmb.e ollukëve-kulmit	83.90	83.93	0.03
5370-40	Shpen.e mirmb.të Zyreve	144.24	261.81	117.57
5370-41	Shpenz.e mirmb.shtepizave		876.19	876.19



5370-43	shpenz.e mirëmbaj.telefonave	28.00		(28.00)
5370-44	shpenz.mirëmbaj,Peronav		182.20	182.20
5370-45	Shpenz role per tripod		124.15	124.15
5370-47	Mirëmb,dhe mbush,klimav	91.08	122.87	31.79
5370-48	Mirëmbajtja,web faqes FastCo	56.99	59.32	2.33
5370-49	shpenz,projekt ideor ndar,z	2,140.45	1,953.00	(187.45)
5370-50	Shpenz mirëmbajtja web faqe		296.66	296.66
5370-51	Shpenz mirë,email,hostim,we		310.00	310.00
5370-52	Mirëmb,e sistemit te parking		4,872.89	4,872.89
5370-53	SHpenz,dezinspektim,te zyr		350.00	350.00
5370-54	shpenz,mirëmbajtje,IT		249.83	249.83
<b>537</b>	<b>SHPENZIMET E MIREMBAJTJES D</b>	<b>11,351.82</b>	<b>44,591.96</b>	<b>33,240.14</b>
5390-1	Shpen.e ujit		624.85	624.85
5390-3	Shpen.e sanitaris	1,539.99	2,135.06	595.07
5390-4	Shpe.e aftësi.te punt.EVP	214.84		(214.84)
5390-5	shpenz.deriv.kosa barit		3.30	3.30
5390-6	Shpen.e sigur.te vetures	498.54	734.23	235.69
5390-9	Shpenz.për ekskurzion	1,280.70	2,067.54	786.84
5390-10	Shpen.e provizi.Bankar	685.39	653.06	(32.33)
5390-12	Shp.për ndihmë puntorve	2,200.00		(2,200.00)
5390-11	Shp.shpallje,e f.		30.00	30.00
5390-13	Mirëmbaj.dhe larja e veturës	28.86	71.49	42.63
5390-14	Dhurata per punëtor		190.00	190.00
5390-15	Shpenz.e tatimit në pronë	3,979.10	3,450.56	(528.54)
5390-16	shpenz.e borxheve te keqia	9.00	22.88	13.88
5390-17	Shpenz,ekspertiza gjyqsore		500.00	500.00
5390-18	Shpenz.e antarsimit	120.00	120.00	-
5390-20	Rroba pune per punëtor	226.22	3,616.62	3,390.40
5390-21	Shpen.Audit,jashtem-konsule		300.00	300.00
5390-24	Bler.e mjet.deri 1000.00 f	76.27	2,716.12	2,639.85
5390-25	Shpenzimet e taxit-transpor	143.25	69.85	(73.40)
5390-27	Shpe.letër,arka,fisk,tripod	7,624.08	717.93	(6,906.15)
5390-28	Shpe.e maki.nxeme tj.nën 1	83.90	200.00	116.10
5390-30	Shpe.e Matj.rezis.përtokëzi	430.00	430.50	0.50
5390-33	Shpen.per taksa gjyqsore	67.00	97.60	30.60
5390-34	Gjoha gjyqsore	1,089.00	140.72	(948.28)
5390-37	Shpen.e Noterit	12.00		(12.00)
5390-39	Blerja e librave		69.40	69.40
5390-40	Blerja e mater.te imt.punue	1,035.13	1,982.27	947.14
5340-41	Gjoha tatimore për ATK	1,741.73		(1,741.73)
5390-42	Shpen.për parking të veturë		25.15	25.15
5390-43	Shpenz.për Llogo të stacio.		42.00	42.00

5390-46	Shpenz. e Dergesave në pik		43.95	43.95
5390-48	Shpen. e parkingut te veture		3.70	3.70
5390-53	Shpenzimet për ID kartel		103.36	103.36
5390-55	Shpenzi taksa komunale	195.27		(195.27)
5390-58	Shpen. e folis të reklamave	22.03	466.10	444.07
5390-59	Shpenz. per foto. print. lid	642.67	829.32	186.65
5390-60	Shpenz per pun fizike	40.00	2,710.00	2,670.00
5390-61	Shpen. e driv a. për gjenerato	530.71	419.50	(111.21)
5390-62	Shpenz. për Licenc MI	3,000.00		(3,000.00)
5390-63	Shpenz. vlrësimit të objekteve	1,605.91		(1,605.91)
5390-64	Shpenz. bartje mj. NLB- siguri		4,652.34	4,652.34
5390-65	Shpenz. vler. qiras. lokalet a		912.00	912.00
5390-66	Shpenz. për projekte		2,595.00	2,595.00
5390-67	Shpenz. pagave sipas vend. gj		2,513.21	2,513.21
5390-68	shpenz. e kontr. mësor te pu		3,640.00	3,640.00
5390-69	Shpenz. printim, dizajn		2,810.51	2,810.51
5390-70	shpenz. plin ne holl		139.84	139.84
5390-71	Shpenz. shërbim te zerimit		50.00	50.00
539	<b>SHPENZIMET E TJERA OPERATIV</b>	<b>29,121.59</b>	<b>42,899.96</b>	<b>13,778.37</b>
5400-1	Zhvlerësimi i ndërtësive	225,246.60	56,087.53	(169,159.07)
5400-2	Zhvlerësimi i inventarit dhe paisjeve	19,942.18	22,283.88	2,341.70
5400	Zhvlerësimi i asetëve	245,188.78	78,371.41	(166,817.37)
<b>5</b>	<b>Gjithsej klasa</b>	<b>1,277,171.19</b>	<b>1,079,983.68</b>	<b>(197,187.51)</b>

**Te hyrat**

Kont	Pershkrimi	vit 2018	vit 2019	Diferenca 2018 - 2019
6110-1	Të hyrat nga shërbimi i Sta	24,597.20	47,630.19	23,032.99
6110-4	Të hyrat nga parkingu	115,493.45	120,551.50	5,058.05
6110-5	Të hyrat nga provizion	35,040.54	30,096.46	(4,944.08)
6110-6	Të hyrat nga peronizimi	557,203.96	527,624.95	(29,579.01)
6110-7	Të hyrat nga shërbimi portë	15,332.25	52,590.74	37,258.49
6110-8	Të hyrat nga gardero	0.84	136.43	135.59
6110-9	Të hyrat nga kartel, hyrje, d	159.41	80.51	(78.90)
6110-10	Të hyrat nga FLEXUS-reklama	114.41	380.00	265.59
6110-11	Të hyrat, plat 0.10	60,860.49		(60,860.49)
6110-12	Të hyrat, plat 0.50	15,380.93		(15,380.93)
6110-13	Të hyrat plat 1.00	23,944.03	514.40	(23,429.63)
6110-14	Të hyrat plat 5.00	228.80		(228.80)
6110-15	Të hyrat plat 16	907.85		(907.85)
6110-16	Të hyrat plat 18	259.31		(259.31)
6110-17	Të hyrat mujo. 20 dhe 25 Fumi	3,610.87	1,260.63	(2,350.24)
6110-19	Të hyrat A. SH. muj. 13.50 dhe 2	19,163.10	6,236.46	(12,926.64)
6110-20	Të hyrat nga 3.00	3,806.39	767.79	(3,038.60)
6110-21	Të hyrat nga mblylla e avansit	11,408.68		(11,408.68)
<b>6110</b>	<b>TE HYRAT NGA SHITJA E PRODH</b>	<b>887,512.51</b>	<b>787,870.06</b>	<b>(99,642.45)</b>
6130-1	Të hyrat nga qirat	166,671.81	181,756.29	15,084.48
6130-2	Të hyrat nga qirax h. -rry	38,410.55	38,462.17	51.62
6130-3	Të hyrat nga qirax h. -uji	5,111.37	5,435.00	323.63
6130-4	Të hyrat nga qirax h. -mbetur	3,602.90	576.00	(3,026.90)
6130-6	Të hyrat nga shërb. me uj		525.42	525.42
<b>6130</b>	<b>TE HYRAT NGA QIRAT e</b>	<b>213,796.63</b>	<b>226,754.88</b>	<b>12,958.25</b>
6700-1	Të hyrat nga shitja e Mj. The		187.71	187.71
6700-2	Të hyrat nga shitja e barit		169.49	169.49
6700-5	Të hyrat nga asgjasi mjete		389.82	389.82
6700-6	Të hyrat nga demtimi laures		92.97	92.97
<b>6700</b>	<b>FITIMI NGA SHITJA E MJ. TH. D</b>		<b>839.99</b>	<b>839.99</b>
<b>6</b>	<b>Gjithsej klasa</b>	<b>1,101,309.14</b>	<b>1,015,464.93</b>	<b>(85,844.21)</b>

### Shtojca 3: Rekomandimet e auditorit te jashtëm

#	Rekomandimi i ZKA 2018	E zbatuar/e pazbatuar	Viti	Viti i/e/përfunduar
1	<b>Rekomandimi A1</b> Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që secili zë i pasqyrave financiare të paraqes vlerën e saktë dhe të mbështetur nga informatat e kontabilitetit të cilat janë të dokumentuara me dëshmi relevante dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.	E zbatuar	2018	2020
2	<b>Çështja B1</b> Planifikimi i dobët i të hyrave dhe shpenzimeve në planin e biznesit	Pjesërisht e zbatuar	2018	2019 – zbatimi 2020
3	<b>Çështja A2</b> Mangësi në menaxhimin e pasurive	Pjesërisht e zbatuar	2018	2019 – zbatimi 2020
4	<b>Çështja A3</b> Pagesa e shpërblimeve/ bonuseve për punëtorët e Ndërmarrjes	E zbatuar	2018	2019
5	<b>Çështja A4</b> Rekrutimi i punonjësve pa shpallje të konkursit publik	E zbatuar	2018	2019
6	<b>Çështja A5</b> Vendimet për sistemim të punëtorëve të bazuara në rregullore të shfuqizuara	E zbatuar	2018	2019
7	<b>Çështja A6</b> Sistemimi i punëtorëve nëpër pozita të punës pa përgatitje adekuate profesionale	E zbatuar	2018	2019
8	<b>Çështja A7</b> Dobësi në faturim për lokalet në shfrytëzim të përkohshëm	E zbatuar	2018	2019
9	<b>Çështja A8</b> Realizimi i të hyrave pa kontratë	Pjesërisht e zbatuar	2018	2019 ndërsa ne 2020 do te behën te gjitha kontratat
10	<b>Çështja B2</b> Mbledhja e të hyrave jo në pajtim me rregulloren	Pjesërisht e zbatuar	2018	2019 /asete te zhvlerësuar dhe te shkatërruara
11	<b>Çështja B3</b> Dobësi në menaxhimin e obligimeve komunale të qiramarrësve	Pjesërisht e zbatuar	2018	Mbeturinat ne 2019 ndërsa KEDS 2020 , kurse ujësjellësi kemi përgjigje negative

12	<b>Çështja B4</b> Blerja e mallrave dhe shërbimeve pa procedura të prokurimit	E zbatuar	2018	2019
13	<b>Çështja A9</b> Ndarje e tenderëve dhe mos aplikimi i procedurës së hapur të prokurimit	E zbatuar	2018	2019
14	<b>Çështja A10</b> Mjetet e mbledhura nga biletë-shitësit depozitohen me vonesë në arkën kryesore	E zbatuar	2018	2019
15	<b>Çështja B5</b> Prezantim jo i plotë i shënimeve shpjeguese	E zbatuar	2018	PFV 2019 te paraqitura ne 2020
16	<b>Çështja B6</b> Mos aprovimi i planit të Auditimit të Brendshëm nga Komisioni i Auditimit	Pjesërisht e zbatuar	2018	2020
17	<b>Çështja A11</b> Mos plotësimi i pozitës me zyrtarin certifikues	E zbatuar	2018	2019
18	<b>Çështja B7</b> Pranimi i faturave të pa protokolluara	E zbatuar	2018	2019
19	<b>Çështja B8</b> Dobësi në menaxhimin e rreziqeve	E zbatuar	2018	2019

